

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në çështjen penale kundër të akuzurit B. B. nga Gj...i, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 par.6, lidhur me par.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II, nr. 636/2016, të datës 18.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, oral dhe publik, më datën **03.01.2018**, bie dhe në prezencë të palëve, publikisht shpall, ndërsa, më dt. 13.01.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.B., nga babai N. dhe nëna L., e lindur R., i lindur më dt. ... në Gj..., jeton, në rr. e K..., "...", i martuar, babai tre fëmije, i papunë, ka të kryer shkollën e mesmei i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas-se i-e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë ..., rreth orës 15.00 min. në rr. "M. I." në GJ, përballë Stacionit Policor, duke drejtuar automjetin taxi "Shaq", të markës "S. O.", ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit 06-632-AC, ka shkelur nenin 54. I të LSKRR dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që, nuk u është përmbajtur dispozitave të lartëpërmendura që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit që automjetin ta ngasë me shpejtësi adekuate dhe sjellje e cila i lejon që ta kontrollojë automjetin në kushte ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht, , duke pasur parasysh pamjen, , kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet dhe ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacioni, në mënyrë që automjetin ta ndalë para çdo pengese, lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shkaktojë pasoja të ndaluara, ashtu që, me të arritur në vendin e cekur, për shkak se nuk ia ka përshtatur shpejtësinë kushteve të rrugës, , me pjesën e përparme të majtë, e ka goditur biçikletën, të cilën ishte duke e drejtuar tani i dëmtuari P. M., me ç'rast përveç dëmit material, lëndime të lehta trupore në formë të ndryshjeve të indeve të buta të gjurit të majtë, të përcjellura me gërvishje të indit lëkuror, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

- me çka ka kryer vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, andaj, bazuar dispozitat e neneve 7, 17, 41, 46, 73, të KPRK-së, dhe neni 358 dhe 453 të KPPRK-së,

E D Ë N O N M E D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarin Behar Bunjaku, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Për ushtrimin e kërkesës pasuroro-juridike, i dëmtuari udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (nëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP. II, nr. 836/2016, të datës 18.04.2016, kundër të akuzuarit Behar Bunjaku, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par.6, lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njejtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Prokurorja Huma Jetishi, deklaroi se me vetë fatin se i akuzuari Behar Bunjaku e ka pranuar fajsinë dhe se pranimi i fajsisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, të pa ndikuar nga askush, duke i kuptuar si pasojat dhe privilegjet e saj, meqë tani janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPRK-se, gjendja faktike lidhur me këtë vepër penale, tani me nuk është kontestuese, e mbi këtë gjendje faktike rezultojnë edhe elementet themelore të veprës penale të kualifikuar në aspektin juridik si rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6, lidhur me par.1 të KPRK-së, prandaj bazuar në pranimin e fajsisë dhe të provave materiale që ndodhen në shkresat e lëndës, i propozoi gjykatës që të akuzuarin Behar Bunjaku ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim meritor sipas ligjit, i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale si dhe natyrën e lëndimeve të shkaktuara të dëmtuarit me këtë vepër penale.

I dëmtuari Pines Milazimi, deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, por, kërkon kompensimmateral.

I akuzuari Behar Bunjaku, në fund të procedurës deklaroi se i vjen keq për këtë vepër penale, premtoi se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në vozitje, andaj, kërkon nga gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari Behar Bunjaku e ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378, par.6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, gjë e cila u vërtetua edhe me ekspertizën e komunikacionit nga eksperti Labinot Neziri, sipas të cilit aksidenti në fjalë ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së të akuzuarit, i cili nuk është siguruar se a ekziston momenti dhe dukshmëria adekuate deh hapësira e mjaftueshme që të bëjë kthim në të djathtë aq shpejt, pa penguar dhe rrezikuar pjesëmarrësit tjerë të komunikacionit.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajsinë, ka pasur sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në vozitje, dhe nuk do të kryer vepra tjera penale, ndërsa, si rrethanë rënduese, pati parasysh rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasuroro – juridike është bazuar në nenin 463 të KPPRK-së

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

P.nr. 493/16, më datë 15.01.2018

**Gjykatësja e vetme gjyquese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të së njejtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.